



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2528, datë 24.11.2014

Për

Anullimin e vijimit të procedurës Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 - 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 - 1920 MHz”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 24.11.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP , shqyrtoi çështjen me objekt:

Anullimin e vijimit të procedurës Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 - 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 - 1920 MHz”.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

3. VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 pika 1.3 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar;
4. Vendim Nr.2491, datë 17.07.2014 Për Miratimin e dokumentit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 – 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz” dhe Njoftimin për tender publik.
5. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Relacioni përkatës;
- Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP me Vendimin Nr. 2507 datë 30.10.2014 miratoi Raportin Përmbledhës të KVO dhe Njoftimin e fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 – 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz”, Ref. 3-2x5+5-2014”.
2. AKEP me shkresën Nr. 1915/13 datë 06.11.2014 i përcolli Plus Communication sh.a. Njoftimin e fituesit sëbashku me detyrimet financiare përkatëse për të drejtat e përdorimit të brezit të frekuencave të fituara në këtë procedurë tenderi.
3. Në përputhje me parashikimet në dokumentin e tenderit, Kreu II, seksion 17, pika 1, duhej që brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga data e këtij njoftimi Plus Communication sh.a. të kryente pagesën e plotë prej 2.970.066 (dymilion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë) Euro, në Buxhetin e Shtetit.
4. Plus Communication sh.a. i klasifikuar dhe njoftuar si fitues për marrjen e 2 të drejtave të përdorimit (2x10 MHz) në brezin e frekuencave 1965 – 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz nuk arriti të përmbushte në afat shlyerjen e detyrimeve financiare të përcaktuara në:

- a) Nenin 68 pika 9) - *“Fituesi i së drejtës për përdorimin e frekuencave, që jepen me procedurën e konkurrimit publik, sipas nenit 69 të këtij ligji, kryen një pagesë për frekuencat në vlerën e arritur në procesin e konkurrimit, e cila derdhet në Buxhetin e Shtetit”* i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 *“Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar;
- b) Kreu V, Dispozita të vecanta: Pagesat , paragrafi 1.1, *“Ofertuesi fitues do të marrë autorizimin individual vetëm pasi të ketë kryer pagesat e parashikuara sipas ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe 1.2, të VKM 1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar;*
- c) Dokumenti i Tenderit, miratuar me V.K.D nr.2491, date 17.07.2014, të AKEP, Ftesa për ofertë Paragrafi IX, DHËNIA E AUTORIZIMIT NGA AKEP, *“Dhënia e Autorizimit Individual do të bëhet brenda 10 ditëve kalendarike pas shpalljes së fituesit dhe kryerjes të gjithë pagesave të referuara në Seksionin 17 të Kreut II sipas përcaktimeve të dokumentit të tenderit dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar. Çmimi i ofertës, i ofruar nga ofertuesi që ka fituar të drejtën e përdorimit të frekuencës/brezit të frekuencave të tenderuar, derdhet prej tij në Buxhetin e Shtetit në përputhje me përcaktimet e njoftimit të AKEP për këtë qëllim. Kjo pagesë do të kryhet nga ofertuesi fitues brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit të fituesit, paragrafi 17, Pagesat që kryen fituesi, “Çmimi i ofertës, i ofruar nga ofertuesi që ka fituar të drejtën e përdorimit të frekuencës/brezit të frekuencave të tenderuar, derdhet prej tij në Buxhetin e Shtetit në përputhje me përcaktimet e njoftimit të fituesit nga AKEP për këtë qëllim. Kjo pagesë e cmimit të ofertës do të paguhet e plotë dhe do të kryhet nga ofertuesi fitues brenda 7(shtatë) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit të fituesit. Brenda këtij afati, ofertuesi fitues duhet të paraqesi pranë AKEP dokumentin bankar që vërteton kryerjen e kësaj pagese. Nëse fituesi dështon në kryerjen e kësaj pagese brenda këtij afati, ai humbet të drejtën për marrjen e Autorizimit Individual”, dhe Ofertuesi fitues para marrjes së Autorizimit individual do të kryejë edhe pagesat e parashikuara në kuadrin ligjor dhe rregullator për sipërmarrësit e rrjeteve dhe ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, si me poshte:*
- i. *Pagesë vjetore për përdorimin e frekuencave në brezat 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz, e cila do të llogaritet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.599 datë 23.07.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare”*
 - ii. *Pagesën vjetore për tarifën e shërbimit për shërbimet e radiokomunikimit, për brezat e frekuencave në brezat 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz, e cila llogaritet sipas Udhëzimit nr.28 dt.20.10.2008 (Ky Udhëzim gjendet në faqen elektronike të AKEP në adresën www.akep.al.”*

5. "Plus Communication" sh.a. me anë të shkresë me Nr.Prot. 1064, datë 13.11.2014, njoftoi kryerjen e pagesave, të mëposhtëme:
- i. Pagesën prej **100,000** (njëqindë mijë) Euro në Buxhetin e Shtetit, nga 2.970.066 (dymilion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë) Euro që është çmimi i ofertës.
 - ii. Pagesën për përdorimin e frekuencave të brezit 1970 - 1980 MHz çiftuar me 2160- 2170 MHz, në shumën **466,667** (katërqindë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqindë e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë, për vitin 2014.
 - iii. Tarifën e shërbimit për shërbimet e radiokomunikimit, për brezat e frekuencave 1970 - 1980 MHz çiftuar me 2160 - 2170 MHz, në shumën **1,111,320** (një milion e njëqindë e njëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzetë) Lekë, për vitin 2014.
6. Ofertat për të drejtat e përdorimit të cilat do të vlerësoheshin në raundin e parë të vlerësimit ku bënte pjesë edhe oferta e Plus Communication sh.a. ishin të vlefshme vetëm për ofertues që nuk kishin një Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave të këtyre brezave.
7. VKM Nr.1252, e ndryshuar, në Kreu III ZHVILLIMI PROCEDURAVE pika 9, "Anullimi i tenderit" paragrafi 9.1, "AKEP lejohet që, në çdo kohë, të anulojë tenderin, për arsye të interesit publik, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës. AKEP në asnjë rast nuk është i detyruar të shpallë fituesin për një tender" dhe paragrafi 9.2, "AKEP nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve, që kanë paraqitur oferta, për vendimin e marrë në bazë të pikës 9.1 të këtij kreu".
8. Interesi publik për brezin e frekuencave për të cilat AKEP nuk arriti nënshkrimin e Autorizimit Individual me fituesit e tyre sipas Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 - 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 - 1920 MHz", është më i lartë në nxjerrjen e tyre sëbashku në bllok frekuencash në Procedure Konkurrimi Publik sipas ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
9. Në kushtet sa më sipër AKEP duke konsideruar interesin publik çmon mbështetjen në bazën ligjore (pika 9.1, "AKEP lejohet që, në çdo kohë, të anulojë tenderin, për arsye të interesit publik, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës. AKEP në asnjë rast nuk është i detyruar të shpallë fituesin për një tender" e VKM Nr.1252 datë 10.09.2008) për anulimin e vijimit të procedurës.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 "Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave", i ndryshuar, pika 9.1, "AKEP lejohet që, në çdo kohë, të anulojë tenderin, për arsye të interesit publik, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës. AKEP në asnjë rast nuk është i detyruar të shpallë fituesin për një tender" dhe pika 19.4, "Kur ofertuesi fitues nuk arrin të nënshkruajë autorizimin individual, AKEP bën konfiskimin e sigurimit të ofertës dhe për zgjedh ofertuesin e radhës në listën e ofertuesve që kanë mbetur."

V E N D O S:

1. Anullimin e vijimit të procedurës Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 – 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz".
2. Të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e AKEP.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI _____
2. Alketa MUKAVELATI _____
3. Benon PALOKA _____
4. Zamira NURÇE _____